



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori i Specializuar k. Pjetër Shalës

Vendosi: Trupi Gjykues I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 13 korrik 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të
Vendimit F00538**

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**

Aleks Uajting

Mbrojtjes së të akuzuarit
Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

TRUPI GJYKUES I ("Trupi Gjykues") lëshon këtë vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin dhe/ose Rishikimin e Vendimit F00538.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 8 qershor 2023, Trupi Gjykues lëshoi vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Njohura dhe Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera ("Vendimi i Kundërshtuar"), në të cilin bëri konstatim gjyqësor, ndër të tjera, të fakteve të propozuara 53 dhe 56, të shqyrtuara në procese të tjera.¹
2. Më 22 qershor 2023, Mbrojtja e Pjetër Shalës (përkatësisht "Mbrojtja" dhe "i akuzuari") dorëzoi kërkesë për leje për apelimin dhe/ose rishikimin e Vendimit të Kundërshtuar ("Kërkesa").²
3. Më 5 korrik 2023, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") iu përgjigj Kërkesës ("Përgjigjja").³
4. Mbrojtësi i Viktimave nuk dorëzoi përgjigje dhe Mbrojtja nuk dorëzoi kundërpërgjigje.

II. PARASHTIRMET

5. Mbrojtja kërkon leje për të apeluar dy pikat e mëposhtme (bashkërisht, "dy pikat"):

¹ KSC-BC-2020-04, F00538, Trupi Gjykues I, [Decision on the Prosecution motion for judicial notice of facts of common knowledge and adjudicated facts](#) (Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Njohura dhe Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera), 8 qershor 2023, publik, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

² KSC-BC-2020-04, F00554, Mbrojtja, *Kërkesë për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Konstatim Gjyqësor të Fakteve të Njohura dhe Fakteve të Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 22 qershor 2023, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 qershor 2023, F00554/RED.

³ KSC-BC-2020-04, F00564, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje për Apelim dhe/ose Rishikim të Vendimit mbi Faktet e Shqyrtuara në Procese të Tjera*, 5 korrik 2023, publike.

- (i) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe ligjor kur bëri konstatim gjyqësor të fakteve të propozuara 53 dhe 56, të shqyrtuara në procese të tjera (bashkërisht, "dy faktet"), me çka në mënyrë të palejueshme ia barti Mbrojtjes detyrimin e vërtetimit në lidhje me aspektet e përfshira në to ("pika e parë"); dhe
- (ii) Nëse Trupi Gjykses bëri gabim faktik dhe ligjor kur bëri konstatim gjyqësor të fakteve të kundërshtuara të lartcekura, të cilat u shqyrtuan në procesin gjyqësor *Sabit Geci dhe të tjerët*, që Prokuroria e ka trajtuar si të pambështetshëm ("pika e dytë").⁴

6. Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykses gaboi që bëri konstatim gjyqësor të dy fakteve, në kundërshtim me të drejtën e të akuzuarit për gjykim të drejtë dhe interesat e drejtësisë.⁵ Sipas Mbrojtjes, dy pikat ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë të procesit si dhe në rezultatin e mundshëm të gjykimit,⁶ dhe një zgjidhje e menjëhershme nga ana e Panelit të Apelit do t'i kontribuonte thelbësisht procesit.⁷ Si alternativë, Mbrojtja kërkon rishikimin e konstatimeve në Vendimin e Kundërshtuar, për të parandaluar padrejtësi.⁸

7. ZPS-ja përgjigjet se në Kërkesë nuk identifikohen pika të apelueshme, dhe se Trupi Gjykses duhet ta rrëzojë Kërkesën edhe vetëm mbi këtë bazë.⁹ ZPS-ja më tej argumenton se Mbrojtja nuk demonstroi se si dy pikat ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit,¹⁰ dhe shton se një vendim i menjëhershëm i apelit nuk do t'i kontribuonte thelbësisht procesit në këtë fazë.¹¹ Për

⁴ Kërkesa, para. 6.

⁵ Kërkesa, para. 4, 16-19.

⁶ Kërkesa, para. 24.

⁷ Kërkesa, para. 25.

⁸ Kërkesa, para. 7, 23.

⁹ Përgjigja, para. 3.

¹⁰ Përgjigja, para. 13.

¹¹ Përgjigja, para. 15-16.

sa i përket kërkesës së Mbrojtjes për rishikimin e vendimit, ZPS-ja parashtron se Mbrojtja nuk ka dhënë arsye pse duhet të rishikohen konstatimet e Trupit Gjykues.¹²

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

8. Trupi Gjykues bazohet në nenet 21 dhe 45(2) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 77(1) dhe (2) dhe 79 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe përfshin përmes referencave standardin për miratimin e lejes për apel sipas rregullës 77(2) të Rregullores, të shtjelluar në vendime të mëparshme.¹³

IV. ANALIZË

A. KËRKESA PËR LEJE PËR APEL

1. Pika e parë

9. Trupi Gjykues vëren se argumenti që paraqet Mbrojtja në lidhje me pikën e parë është i dyfishtë. Së pari, Mbrojtja argumenton se Trupi Gjykues gaboi që nuk e interpretoi rregullën 157 të Rregullores në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“KEDNJ”) dhe nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës,¹⁴ me çka barti detyrimin e vërtetimit tek i akuzuari

¹² Përgjigja, para. 18.

¹³ KSC-BC-2020-04, F00401, Trupi Gjykues I, [Decision on Request for Leave to Appeal the Decision Concerning Prior Statements Given by Pjetër Shala](#), (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala), 24 janar 2023, publik, para. 13-20; F00116, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Application for Leave to Appeal “Decision on Motion Challenging the Form of the Indictment”](#) (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin për Mangësi në Formën e Aktakuzës, 29 nëntor 2021, publik, para. 11-13.

¹⁴ Kërkesa, para. 16.

dhe keqpërdori kompetencën diskrecionale.¹⁵ Në veçanti, Mbrojtja argumenton se vendimi i Trupit Gjykues për të bërë konstatim gjyqësor të dy fakteve do të thotë që tani Mbrojtja duhet të kundërshtojë faktet e pranuar dhe elementet që ato përmbajnë, çka do të ndikojë në llojin dhe kuadrin e provave që Mbrojtjes do t'i duhet të paraqesë gjatë fazës së paraqitjes së provave të saj.¹⁶ Mbrojtja shton se u vu në dijeni për këtë vetëm pak para fillimit të planifikuar të paraqitjes së provave të saj.¹⁷ Së dyti, Mbrojtja argumenton se dy faktet kanë lidhje të drejtpërdrejtë me elementet e veprave penale për të cilat akuzohet i akuzuari. Mbrojtja pretendon se, duke pasur parasysh se i akuzuari po përballlet me gjykimin më shumë se dy dekada mbas ngjarjeve të pretenduara, dhe ndonëse i ka shkëputur të gjitha lidhjet me Kosovën pas luftës, interesi i drejtësisë kërkon që ZPS-ja të provojë akuzat e veta në lidhje me këto pika sipas standardit të duhur.¹⁸

10. ZPS-ja përgjigjet se pika e parë përbën thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar dhe se Mbrojtja nuk pranon ose nuk trajton: (i) natyrën diskrecionale të konstatimit gjyqësor të fakteve që lidhen me thelbin e akuzave të Prokurorisë; (ii) natyrën dhe qëllimin e rregullës 157(2) të Rregullores, dhe (iii) detyrimin e Trupit Gjykues për të garantuar të drejtat e të akuzuarit.¹⁹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtrohet se, ashtu siç është pranuar dhe nga Mbrojtja, dy faktet nuk kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit.²⁰ ZPS-ja shton se konstatimi gjyqësor i fakteve nga Trupi Gjykues nuk e bart detyrimin e vërtetimit të Mbrojtja, por krijon prezumim të kundërshtueshëm të saktësisë së këtyre fakteve.²¹ Sipas ZPS-së, ky prezumim nuk shkel të drejtat e të akuzuarit.²²

¹⁵ Kërkesa, para. 16-19.

¹⁶ Kërkesa, para. 18.

¹⁷ Kërkesa, para. 18.

¹⁸ Kërkesa, para. 19.

¹⁹ Përgjigja, para. 4.

²⁰ Përgjigja, para. 5, 7.

²¹ Përgjigja, para. 7.

²² Përgjigja, para. 8.

11. Trupi Gjykues rikujton se, sipas kriterit për miratimin e lejes për apelim, kur një vendim nuk është i apelueshëm sipas Ligjit dhe Rregullores, vetëm një “pikë” mund të shërbejë si bazë për apelimin e një vendimi në bazë të rregullës 77 të rregullores. Termi “pikë” përshkruhet si një temë ose lëndë e identifikueshme që buron nga Vendimi i Kundërshtuar, zgjidhja e së cilës është kyçe për marrjen e vendimit mbi problemet që dalin në çështjen gjyqësore që shqyrtohet, dhe jo thjesht një temë për të cilën ka mospajtime ose mendime të kundërta.²³

12. “Kryerja e drejtë dhe e shpejtë e procesit” në rregullën 77 (2) të Rregullores përgjithësisht kuptohet se u referohet normave të gjykimit të drejtë.²⁴

13. Trupi Gjykues vlerëson se pika e parë buron nga Vendimi i Kundërshtuar sepse lidhet me pasojat e konstatimit gjyqësor të dy fakteve, të bërë nga Trupi Gjykues. Rrjedhimisht, është pikë e apelueshme.

14. Për sa i përket diskutimit nëse pika e parë ndikon ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, Trupi Gjykues rikujton se konstatimi gjyqësor i fakteve të shqyrtuara në procese të tjera në asnjë mënyrë nuk e liron ZPS-në nga detyrimi i vërtetimit jashtë dyshimit të arsyeshëm të përgjegjësisë penale individuale të të akuzuarit në lidhje me krimet dhe format e përgjegjësisë penale të paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.²⁵ Sikurse theksohet në Vendimin e Kundërshtuar, me konstatimin gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, Trupi Gjykues krijon prezumim të kundërshtueshëm të saktësisë së këtyre fakteve.²⁶ Mbrojtja ka të drejtë të kundërshtojë këtë prezumim duke paraqitur prova të besueshme dhe të mbështetshme në gjykim. Asgjë nuk është provuar në këtë fazë, dhe Trupi Gjykues do

²³ KSC-BC-2020-04, F00401, Trupi Gjykues I, [*Decision on Request for Leave to Appeal the Decision Concerning Prior Statements Given by Pjetër Shala*](#), (Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me Deklaratat e Dhëna më Parë nga Pjetër Shala), 24 janar 2023, publik, para.15 (“Vendimi mbi Kërkesën e Shalës për Leje për Apelim”).

²⁴ Vendimi mbi Kërkesën e Shalës për Leje për Apelim, para. 17.

²⁵ *Shih për ngjashmëri* Vendimin e Kundërshtuar, para. 27.

²⁶ *Shih* Vendimin e Kundërshtuar, para. 27, me referencat shoqëruese.

të vlerësojë besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e provave duke pasur parasysh tërësinë e provave. Kundërshtimi i këtij mekanizmi do të thotë mospajtim me ekzistencën dhe funksionin e rregullës 157. Ky mospajtim nuk mund të jetë bazë për formulimin e një kërkesë sipas rregullës 77 të Rregullores.²⁷ Mbrojtja nuk shpjegon më tej shkeljet e pretenduara të nenit 6(2) të KEDNJ-së. Në këto rrethana, Trupi Gjykes nuk mund të pranojë sugjerimin e Mbrojtjes se Vendimi i Kundërshtuar rezultoi në bartjen e palejueshme të detyrimit të vërtetimit të Mbrojtja.

15. Vlen të theksohet se Mbrojtja nuk duket se kundërshton konstatimin gjyqësor prej Trupit Gjykes të fakteve të tjera të shqyrtuara në procese të tjera duke pretenduar përmbysje të detyrimit të provës. Përkundrazi, argumenti kyç i Mbrojtjes qëndron në faktin se dy faktet kanë të bëjnë me “elemente të rëndësishme” të akuzave të ZPS-së.²⁸ Sidoqoftë, kur ushtron kompetencën diskreionale sipas rregullës 157 të Rregullores, Trupi Gjykes nuk e ka për detyrë të bëjë dallimin midis fakteve të rëndësishme dhe atyre të parëndësishme. Trupi Gjykes ka diskrecionin të bëjë konstatim gjyqësor të çdo fakti relevant, përfshirë faktet që lidhen me thelbin e çështjes gjyqësore, në qoftë se ato nuk kanë të bëjnë me veprimet dhe sjelljen e të akuzuarit.²⁹ Çka është me rëndësi, sipas Trupit Gjykes, Mbrojtja nuk paraqet argumente të mëtijshme që tregojnë *keqpërdorim* të kompetencës diskreionale nga ana e Trupit Gjykes në këtë aspekt. Në veçanti, argumenti i Mbrojtjes se Trupi Gjykes nuk mori parasysh të drejtat e të akuzuarit, është tërësisht i pambështetur.³⁰ Në fakt, pa më shumë

²⁷ Shih vendimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi një argument të ngjashëm të ngritur nga Mbrojtja, KSC-BC-2020-04, F00218, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesën për Masa Mbrojtëse për Dokumente që Përmbajnë Informacion Shfajësues*, 14 qershor 2022, konfidencial, para. 14.

²⁸ Kërkesa, para. 17.

²⁹ Shih, ndër të tjera, ICTY, *Prosecutor v. Dragomir Milošević*, IT-98-29/1-AR73.1, Appeals Chamber, [Decision on Interlocutor Appeals Against Trial Chamber's Decision on Prosecution's Motion for Judicial Notice of Adjudicated Facts and Prosecution's Catalogue of Agreed Facts](#), 26 June 2007, para. 16, me referencat shoqëruese; ICTR *Prosecutor v. Karemera*, ICTR-98-44-AR73(C), Appeals Chamber, [Decision on Prosecutor's Interlocutory Appeal of Decision on Judicial Notice](#), 16 June 2006, para. 52-53.

³⁰ Shih Vendimin e Kundërshtuar, para. 23.

informacion, Trupi Gjykses e ka të vështirë të dallojë se çfarë dëmi konkret u shkaktohet të drejtave të të akuzuarit për t'u prezumuar i pafajshëm dhe për t'i ballafaquar dëshmitarët kundër tij.³¹ Për këtë arsye, pretendimi i Mbrojtjes në këtë aspekt është i pabazë.

16. Për sa i përket argumentit të Mbrojtjes se është njoftuar vonë që do t'i duhet të kundërshtojë elementet që përmbajnë dy faktet, Trupi Gjykses vëren se periodha midis lëshimit të Vendimit të Kundërshtuar dhe datës së caktuar për fillimin e paraqitjes së provave të Mbrojtjes është më shumë se tre muaj. Vështirë se kjo periudhë mund të përshkruhet si "pak para fillimit të planifikuar" të paraqitjes së provave të Mbrojtjes.

17. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka demonstruar se pika e parë ndikon në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk do të marrë në shqyrtim kriteret e tjera për miratimin e lejes për apelim, të parashikuara në nenin 45 (2) të Ligjit dhe rregullën 77 (2) të Rregullores, dhe hedh poshtë këtë pjesë të Kërkesës.

2. Pika e dytë

18. Mbrojtja parashtrohet se Trupi Gjykses gaboi që bëri konstatimin gjyqësor të dy fakteve, duke pasur parasysh se ato burojnë nga procesi gjyqësor *Sabit Geci dhe të tjerët*, që ZPS-ja pretendohet se e konsideron "të pambështetshëm" dhe "haptazi kundërshton rezultatin e tij".³²

19. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja shtrembëron marrjen në pyetje të TW4-01-shit nga ZPS-ja dhe në mënyrë të palejueshme ngre argumente për herë të parë.³³ Në veçanti, ZPS-ja argumenton se: (i) asnjëherë nuk është shprehur se gjykon se nuk mund të mbështetesh në procesin gjyqësor *Sabit Geci dhe të tjerët*; (ii) edhe nëse do të kishte

³¹ Neni 21(3), (4)(f) i Ligjit.

³² Kërkesa, para. 20, 22.

³³ Përgjigjja, para. 9.

pasur një qëndrim për aktgjykimin e çështjes gjyqësore *Sabit Geci dhe të tjerët*, kjo nuk do të ndikonte në kompetencën diskrecionale të Trupit Gjykes për të bërë konstatim gjyqësor të fakteve që burojnë nga ai aktgjykim; dhe (iii) Mbrojtja ngre për herë të parë një pikë të paqartë që nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar, gjë që e bën atë të paapelueshme.³⁴

20. Për sa i përket diskutimit nëse pika është e apelueshme,³⁵ Trupi Gjykes vëren se Mbrojtja shtrembëron qëndrimin e ZPS-së. Trupi Gjykes i kushton vëmendje argumentit të ZPS-së se gjatë marrjes në pyetje të TW4-01-shit u përpoq të sqaronte me të një mospërputhje lidhur me një aspekt specifik, dhe se nuk gjykon se nuk mund të mbështetesh në procesin gjyqësor *Sabit Geci dhe të tjerët*. Pavarësisht nga sa më sipër, në bazë të diskrecionit të vet, Trupi Gjykes vlerësoi me kujdes nëse mund të bëhej konstatim gjyqësor i dy fakteve nga gjykimi i çështjes *Sabit Geci dhe të tjerët* dhe dha arsyetimin e vet për këtë vendim në Vendimin e Kundërshtuar.³⁶ Rrjedhimisht, Trupi Gjykes nuk konstaton lidhje midis qëndrimit të pretenduar të ZPS-së, nëse ka, dhe konstatimeve në Vendimin e Kundërshtuar.

21. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykes konstaton se Mbrojtja nuk ka formuluar një “pikë të apelueshme” të qartë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykes nuk do të marrë në shqyrtim kriteret e tjera për miratimin e lejes për apelim, të parashikuara në nenin 45 (2) të Ligjit dhe rregullën 77 (2) të Rregullores, dhe hedh poshtë këtë pjesë të Kërkesës.

B. KËRKESA PËR RISHIKIM

³⁴ Përgjigjja, para. 10-12.

³⁵ *Shih* para. 11 më lart.

³⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 24-25, 27.

22. Si alternativë, Mbrojtja kërkon rishikimin e vendimit duke pasur parasysh qëndrimin e pretenduar të ZPS-së se procesi gjyqësor *Sabit Geci dhe të tjerët*, nga ku burojnë dy faktet, nuk është i mbështetshëm.³⁷ Mbrojtja argumenton se qëndrimi i ZPS-së për procesin gjyqësor *Sabit Geci dhe të tjerët* përbën arsye të vlefshme për rishikimin e aspekteve të kundërshtuara të Vendimit të Kundërshtuar.³⁸

23. Trupi Gjykses rikujton se, që të merret parasysh kërkesa për rishikim në bazë të rregullës 79 të Rregullores, pala ose pjesëmarrësi që bën kërkesën duhet të demonstrojë ose (i) ekzistencën e arsytimit qartësisht të gabuar, ose (ii) që rishikimi është i domosdoshëm për të parandaluar padrejtësinë. Faktet dhe argumentet e reja që kanë dalë që nga lëshimi i Vendimit të Kundërshtuar mund të jenë relevante për këtë vlerësim. Për shkak të natyrës së vet të jashtëzakonshme, rishikimi nuk mund të përdoret si një mjet juridik i zakonshëm (si “një rrugë tjetër për të paraqitur apel”) për të korrigjuar të metat në një vendim, apo për t’iu shmangur pasojave të pafavorshme. Rrjedhimisht, thjesht mospajtimi me rezultatin ose me arsyetimin e një vendimi nuk mjafton që vendimi të rishikohet.³⁹

24. Trupi Gjykses vëren se Kërkesa nuk përmbush standardin ligjor sipas rregullës 79 të Rregullores, sikurse shtjellohet më sipër. Trupi Gjykses rithekson konstatimin e vet se Mbrojtja shtrembëron qëndrimin e pretenduar të ZPS-së lidhur me gjykimin e çështjes *Sabit Geci dhe të tjerët*.⁴⁰ Mbrojtja nuk thellohet më tej me standardin ligjor sipas rregullës 79 të Rregullores për të demonstruar ose ekzistencën e arsytimit qartësisht

³⁷ Kërkesa, para. 7.

³⁸ Kërkesa, para. 23.

³⁹ KSC-BC-2020-06, F00476, Kryetarja, [Decision on Applications for Reconsideration and Disqualification of a Judge from a Court of Appeals Panel](#), (Vendim mbi Kërkesat për Rishqyrtim dhe Heqje të një Gjykatësi nga Paneli i Gjykatës së Apelit), 17 shtator 2021, publik, para. 11-12; KSC-BC-2020-05, F00046, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Decision on Specialist Prosecutor's Request for Reconsideration or Certification for Appeal](#) (Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Rishikim ose Leje për Apelim), 5 nëntor 2020, publik, para. 14; F00209, Trupi Gjykses I, [Decision on Victims' Counsel request for reconsideration of the third decision on the appointment of expert\(s\)](#) (Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtës së Viktimave për Rishqyrtimin e Vendimit të Tretë mbi Caktimin e Ekspertit (Ekspertëve)), 20 shtator 2021, publik, para. 12.

⁴⁰ Shih para. 20 më lart.

të gabuar, ose arsye të vlefshme që Trupi Gjykses të rishikojë Vendimin e Kundërshtuar, për të parandaluar padrejtësinë.

25. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykses rrëzon edhe këtë pjesë të Kërkesës.

V. VENDIM

26. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses **RRËZON** Kërkesën.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E enjte, 13 korrik 2023

Hagë,

Holandë.